



VENDIM PËR PAPANUESHMËRI

Data e miratimit: 14.09.2011

Nr. i rastit: 2011-14

Lindita Shabani

kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 14 shtator 2011, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Z. Antonio BALSAMO, kryesues
Znj. Magda MIERZEWSKA, anëtare
Znj. Anna BEDNAREK, anëtare

Asistuar nga
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor
Znj. Leena LEIKAS, zyrtare ligjore
Znj. Stephanie SELG, zyrtare ligjore

Pas shqyrtimit të ankesës, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetorit 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe Rregullores së Punës së Panelit me 9 qershor 2010,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

I. PROCEDURAT PARA PANELIT

1. Ankesa është regjistruar më 1 maj 2011. Paneli ka kërkuar informatë shtesë nga parashtruesja e ankesës më 8 qershor 2011. Ajo informatë është pranuar pas një dite.

II. FAKTET

2. Sipas parashtrueses së ankesës, ajo ishte martuar me datën 28 gusht 2005 dhe kishte dy fëmijë me bashkëshortin e saj.
3. Ajo ishte e ndarë nga bashkëshorti i saj gjatë shumicës së kohës, pasi ai jetonte jashtë vendit dhe se gjendej në burg kohë pas kohe, së fundi ai ishte i burgosur në Spanjë. Parashtruesja e ankesës pretendon se ajo ishte viktimë e dhunës në familje nga të afërmit e bashkëshortit të saj. Ajo nuk kishte raportuar tek autoritetet këtë dhunë të dyshuar në familje.
4. Më 18 gusht 2010, bashkëshorti i parashtrueses së ankesës i kishte telefonuar të afërmeve të tij nga Spanja për t'i thënë se ai ishte divorcuar prej parashtrueses së ankesës. Si pasojë, ata e kishin njoftuar parashtruesen e ankesës.
5. Në shtator 2010, parashtruesja e ankesës i kishte lënë fëmijët e saj në familjen e bashkëshortit të saj, pas këmbënguljes së tyre, me shpresë se ajo do të jetë në gjendje t'i shoh fëmijët e saj herë pas here. Tani për tani fëmijët janë në përkujdesje të xhaxhait të tyre në Podujevë. Supozohet se ai i ka thënë parashtrueses së ankesës se bashkëshorti i saj ia kishte ndaluar atij që ajo të vjen për vizitë, dhe si pasojë ajo nuk i ka parë fëmijët e saj që nga shtatori i vitit 2010.
6. Parashtruesja e ankesës, e cila jeton në Lipjan, e kishte njoftuar për shqetësimin e saj Qendrën për Punë Sociale në Podujevë më 11 tetor 2010.
7. Pas pesë (5) përpjekjeve të dështuara midis datave 11 tetor 2010 dhe 25 maj 2011 për të arritur një marrëveshje rreth të drejtës së parashtrueses së ankesës për t'i kontaktuar fëmijët e saj, parashtruesja e ankesës ishte udhëzuar nga Qendra për Punë Sociale me datën 25 maj 2011 t'i mbroj të drejtat e saj përmes procedurave gjyqësore.
8. Në ndërkohë, me 24 janar 2011 parashtruesja e ankesës ka parashtruar një kërkesë për përkujdesje dhe alimentacion për fëmijët e saj në gjykatën komunale të Lipjanit. Me 11 shkurt 2011 kjo gjykatë ka gjetur se nuk ka kompetenca, pasi fëmijët jetojnë në Podujevë.
9. Më pas, parashtruesja e ankesës ka parashtruar një kërkesë të ngjashme në gjykatën komunale të Podujevës. Rasti është ende i pazgjidhur.
10. Me 28 prill 2011, parashtruesja e ankesës ka kontaktuar EULEX-in në Kosovë. Në përgjigjen e tij, shefi i personelit të EULEX-it e kishte këshilluar parashtruesen e ankesës të kërkoj ndihmë prej ndonjë avokati nga Njësia për mbrojtje dhe ndihmë viktimave në Ministrinë e Drejtësisë së Kosovës. Gjithashtu ajo ishte këshilluar të kontaktoj Qendrën për ndihmë ligjore dhe zhvillim regjional, Komisionin për

ndihmë juridike të Kosovës, Rrjetin e grave të Kosovës dhe NORMA (një organizatë jo qeveritare e grave).

11. Për më tej, në maj 2011 parashtruesja e ankesës kishte diskutuar rreth problemeve të saja me një përfaqësues të Këshillit për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut.
12. Supozohet se ajo ka tentuar të kryej vetëvrasje në disa raste.

III. ANKESAT

13. Parashtruesja e ankesës dëshiron të ketë kontakte të rregullta me fëmijët e saj dhe kërkon ndihmë nga Paneli.

IV. LIGJI

14. Para shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesës, Paneli duhet të vendos se a do ta pranoj ankesën, duke marrë parasysh kriterin për pranueshmëri të përcaktuar në Rregulloren 29 të Rregullores së Punës.
15. Sipas Rregullës 25, paragrafi 1 i Rregullores së punës, Paneli mund të shqyrtojë ankesat lidhur me shkeljet e të drejtave të njeriut nga EULEX-i në Kosovë, gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv.
16. Çështjet e ngritura në këtë ankesë kanë të bëjnë me një kontest civil në familje në mes të parashtrueses së ankesës dhe familjes së ish bashkëshortit të saj.
17. Ky rast është i pazgjidhur në gjykatat e Kosovës. Paneli nuk ka juridiksion të vepror si gjykatë e apelit lidhur me vendimet e dhëna nga gjykatat, e as të ndërhyjë në çfarëdo çështje në procedurat e tilla.
18. Si pasojë, çështjet që janë ngritur në këtë ankesë nuk hyjnë brenda mandatit ekzekutiv të EULEX-it në Kosovë, mandat i cili kufizohet në çështjet që kanë të bëjnë me policisë, drejtësinë dhe doganat. Fakti se parashtruesja e ankesës ka kontaktuar EULEX-in në Kosovë për tu këshilluar nuk kuptohet se ky rast bie brenda mandatit ekzekutiv të EULEX-it në Kosovë.

PËR KËTO ARSYE, Paneli njëzëri,

konstaton se nuk ka kompetencë për ta shqyrtuar këtë ankesë, *gjen* se ankesa është e pabazuar sa i përket Nenit 29 (d) të Rregullores së Punës së vet, dhe

SHPALL ANKESËN TË PAPRANUESHME.

Për Panelin,

John J. RYAN
Zyrtar i lartë ligjor

Antonio BALSAMO
Kryesues i Panelit